



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 07, datë 26.04.2022

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“REHABILITIMI I PISTËS SË BAZËS AJRORE TË KUÇOVËS”,**  
**ME VENDNDODHJE NË BASHKINË KUÇOVË**


Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Komandës së Forcës Ajrore (Reparti Ushtarak Nr.3001), Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rehabilitimi i pistës së Bazës Ajrore të Kuçovës”, me vendndodhje në Bashkinë Kuçovë, me subjekt zhvillues Komandën e Forcës Ajrore (Reparti Ushtarak Nr.3001).
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Kuçovë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



**MINISTËR I LINJËS**  
**MINISTËR I MBROJTJES**  
**NIKO PELESHI**



**ANËTAR / SEKRETAR I KKT**  
**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**  
**LEDIA TOTA**

